

VENDIM
Nr. 320, datë 20.8.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
DELVINË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.8.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Delvinë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Delvinë (UK Delvinë) me shkresën nr. prot. 137 prot., datë 19.7.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Delvinë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Delvinë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 16 783 banorë të Bashkisë Delvinë;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Vani Toti është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Inxhinierisë, dega Hidroteknike, në vitin 1986;

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Delvinë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Delvinë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. (me NUIS K46909504W), në kategoritë:
 - a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) drejtues ligjor – Vasil Marga;
 - b) drejtues teknik – Vani Toti.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. është Bashkia Delvinë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani